

THIRRJE PËR OFERTË PËR BLERJE AUTOMJETI **Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS**

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS në kuadër të programeve dhe projekteve që do të zbatohet gjatë vitit 2021, shpall thirrjen për ofertë për blerjen e një automjeti, me qëllim ofrimin e shërbimeve në kuadër të programeve dhe projekteve që zbatohen në terren.

Informacion i Përgjithshëm

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016 me NIPT L61429451E. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjyptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Termet e thirrjes

Janë të ftuar të gjithë bizneset, kompanitë apo individët e licensuar dhe të interesuar për të paraqitur ofertën e tyre financiare dhe për t'u bërë pjesë e procesit të tenderimit. (klikoni në dokumentet më poshtë për të gjetur Kërkesë Ofertën dhe "Praktikat e mira të biznesit").

1. Kërkesë për [ofertë](#),
2. [Praktikat](#) e mira të biznesit.

Kushte të përgjithshme

1. Çmimi i ofruar duhet të jetë me të gjitha taksat e përfshira, targuar dhe duhet të vendoset për bri produktit respektiv, në rubrikën e "Çmimit / njesi".
2. Në rast se përveç çmimit të ofruar, furnitori aplikon edhe % zbritje, atëherë ajo duhet të deklarohet në ofertë.
3. Së bashku me ofertën, furnitori duhet të dorëzojë patjetër edhe një kopje të **NIPT-it / licensës**.
4. Dokumentin e bashkangjitur "Praktikat e mira të biznesit" të plotësuar e të firmosur.
5. Foto të automjetit të ofruar, nga brenda dhe jashtë.

Procedura e aplikimit

Afati i paraqitjes së ofertës financiare duhet të jetë jo më vonë se data **31 dhjetor 2020, ora 16:00**.

Oferta duhet të paraqitet në një nga dy format e mëposhtme:

- Të dorëzohet në zarf të mbyllur, në formë të printuar, firmosur nga një person i autorizuar, në adresën: Rruga "e Kavajës", Pallati A, Shkalla 3, Hyrja 27, Tiranë, KP 1023. Në zarf duhet të shënohet "Ofertë financiare për automjet".
- Të dërgohet me e-mail në format PDF, firmosur nga një person i autorizuar në adresën elektronike: initiative.arsis@gmail.com. Në subjektin e e-mailit duhet të shënohet "Ofertë financiare për "Ofertë financiare për automjet".

Ofertat e dorëzuara pa çmim të specifikuar, pa dokumentat e kërkuara më lart si dhe jashtë afatit të përcaktuar nuk do të merren parasysh.

Kjo thirrje për ofertë financiare nuk e detyron Nisma ARSIS të lidhë kontratë për shërbimin/produktet e listuara sipas kësaj thirrje.

Për çdo informacion të mëtejshëm mund të na kontaktoni në tel **+355 (0) 698233113**, ose e-mail: **initiative.arsis@gmail.com**.



Kerkese Oferte-
Blerje Automjeti.xlsx